



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada-Government**

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës- (SHSKUK)
Univerzitetska Bolnička i Klinička Služba Kosova-(UBKSK)
Hospitaland University Clinical Service of Kosovo-(HUCSK)
Qendra Klinike Universitare e Kosovës- Universitetski Klinikcki Centar
Kosova – University Clinical Center of Kosovo

Raport i Punës

Janar-Dhjetor 2022

17.03.2023



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Përgaditur nga:

Dr. Narqize Arenliu-Hoxhaj- U.D. Drejtor i Përgjithshëm në SHSKUK



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Falënderim:

Falenderim për të gjithë punëtorët shëndetësor dhe atë administrativ për punën e pa lodhshme që kanë treguar dhe po tregojnë çdo ditë e më shumë në ngritjen e kapaciteteve dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Po ashtu një falenderim të veçant është për Bordin Drejtues të SHSKUK-së, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Financave Punës dhe Transfereve, si dhe mbështetja dhe përkrahjen nga donatorët e ndryshëm në realizimi e shumë projekteve gjatë vitit 2022.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Misioni:

Përmirësimi i shërbime shëndetësore të bazuara në cilësi, kohë dhe të përshtatëshme për secilin qytetar.

Vizioni:

Institucione shëndetësore me qasje të lehtë trajtim cilësor dhe të barabartë bazuar në standardet ndërkombëtare për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Përmbajtja:

Hyrje.....	7
Fjala Hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të SHSKUK-së	8
1. Struktura e të punësuarve në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.....	13
2. Performanca e punës në Shërbimin Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës Janar-Dhjetor 2022.....	14
3. Numri i pacientëve dhe shfrytëzueshmëria e kapaciteteve sipas njësive në SHSKUK, Janar-Dhjetor 2023.....	15
4. Shërbimet e kryera në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.....	16
5. Struktura e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës QKUK.....	17
6. Performanca e punës në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës-QKUK-së Janar-Dhjetor- 2022.....	18
6.1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në QKUK -Janar-Dhjetor - 2022.....	20
6.2. Shfrytëzueshmëria e kapaciteteve në klinikat e kirurgjisë	22
6.3. Shfrytëzimi i kapaciteteve në klinikat internistike dhe klinikat tjera.....	23
7. Struktura kualifikuese në Spitalet e Përgjithshme	24
7.1. Performanca e spitaleve të përgjithshme të SHSKUK-së Janar- Dhjetor 2022.....	25
7.2. Shërbimet e kryera në Spitalet e Përgjithshme Janar-Dhjetor 2022.....	26
8. Shërbimet e ofruara nga Qendra Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës (QKSUK).....	27
9. Shërbimet e ofruara në Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive-QKMS.....	28
10. Shërbimet e ofruara në Qendra Kombëtare të Telemjekësisë së Kosovës-QKTK	29
11. Shërbimet e ofruara në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë.....	30
12. Struktura profesionale në Qendrat Profesionale të Shëndeti Mendor-QSHM/SHIB.....	31
12.1. Shërbimet e ofruara nga Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi.....	32
13. Shërbime tjera të ofruara në SHSKUK-së.....	33
13.1. Lindjet e realizuar gjatë vitit 2022 në njësit e SHSKUK-së.....	33
13.2. Shërbimet e dializës në SHSKUK-së, Janar-Dhjetor 2022.....	33
13.3. Shërbimet Radiologjike të ofruara në SHSKUK.....	34
13.4. Shërbimet e kryera në Klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiokirurgjisë-QKUK.....	35
13.5. Shërbimet e kryera në Klinikën e Onkologjisë QKUK.....	36
14. Pacientët e trajtuar me Covid-19, nga njësit e SHSKUK-së- Janar-Dhjetor 2022.....	37
15. Donacionet e pranuar në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës 2022...39	



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Lista e Shkurtesave

SHSKUK- Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës

MSH- Ministria e Shëndetësisë

BD- Bordi Drejtues

MFPT- Ministria e Financave Punës dhe Transfereve

QKUK- Qendra Klinike Universitare e Kosovës

QKUSK- Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës

QKMP- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

QKMS- Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

QKTK- Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës

SP- Spitali i Përgjithshëm

QSHMSHIB- Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi

QIRSKP- Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik

BQ- Barnatorja Qëndrore



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Hyrje:

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) është institucion i formuar sipas Ligjit për Shëndetësi nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përderisa Statuti i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës është miratuar në mbledhjen e 148 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me vendim nr. 05/148, datë 11.09.2013. Formimi i SHSKUK është i saktësuar në nenin 62 të Ligjit për Shëndetësi. Në paragrafin e parë të këtij neni, theksohet se Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës themelohet si institucion autonom dhe i pavarur publik shëndetësor, me rëndësi të veçantë publike, me seli në Prishtinë. SHSKUK përbëhet nga institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor në sektorin publik të shëndetësisë.

Institucionet shëndetësore të nivelit dytësor dhe tretësor të kujdesit shëndetësor, të cilat përbëjnë SHSKUK-në, janë si vijon:

1.1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK);

1.2. Qendra Klinike Universitare Stomatologjike e Kosovës;

1.3. Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës në Gjakovë;

1.4. Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive

1.5. Qendra Kombëtare e Telemjekësisë;

1.6. Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë;

1.7. Spitali i Përgjithshëm në Gjiilan;

1.8. Spitali i Përgjithshëm në Pejë;

1.9. Spitali i Përgjithshëm në Gjakovë;


1.10. Spitali i Përgjithshëm në Prizren;

1.11. Spitali i Përgjithshëm në Ferizaj;

1.12. Spitali i Përgjithshëm në Vushtrri;

1.13. Qendrat e Shëndetit Mendor me Shtëpitë për Integrim në Bashkësi;(Prishtinë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren, Pejë, Gjakovë dhe Gjiilan;

1.14. Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime.





Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Fjala hyrëse e Drejtorit të Përgjithshëm të ShSKUK-së

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në periudhën Janar-Dhjetor 2022 edhe për kundër sfidave të paraqitura dhe ndryshimeve menaxheriale ka punuar në përmbushjen me sukses objektivave të planifikuara të punës gjatë këtij viti.

Vazhdimi i priorizimit të masave të nevojshme në furnizim të rregullt me barna dhe material shpenzues për të gjitha njësit e SHSKUK-së, furnizim me pajisje mjekësore dhe masat e nevojshme në menaxhim sa më të mirë të institucioneve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve dhe rritja e numrit të shërbimeve ishte pjesë e suksesit të punës.

Edhe për kundër sfidave të paraqitura me angazhimin e gjithë stafit në njësit e SHSKUK-së, kemi mundësuar të përmirësojmë furnizim e rregullt me barna, material hargjues dhe pajisje mjekësore. Po ashtu është rrit numri i shërbimeve shëndetësore, përfshirë operacione, shërbime diagnostike, vizita ambulatore dhe kemi ndikuar në zvoglimin e numrit të pacienteve në lista të pritjes.

Bashkëpunim dhe kordinim me Bordin Drejtues të SHSKUK-së, Ministrin e Shëndetësisë, Ministrin e Financave Punës dhe Transfereve, mbështetje dhe përkrahjen nga donatorët e ndryshëm ishin faktori kyq në realizimi e shumë të arriturve gjatë këtij viti. Disa nga sukseset më të veçanta mundë të konsiderojmë si të arritura kryesore të planifikimeve të SHSKUK-së, gjatë kësaj periudhe kohore.

- Përkundër vështirësive dhe telashve nga Pandeminë COVID-19, SHSKUK-së, gjatë vitit 2022 ka rrealizuar disa projekte shumë të rëndësishme dhe të ofroj miliona shërbime mjekësore për pacientët. Rritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për pacientët dhe përmirësimi i kushteve të punës për personelin shëndetësor, ishte përkushtim i plotë dhe angazhim i përditshëm i SHSKUK-së.
- Rritja e bashkëpunimit dhe përkrahja e projekteve investive në të gjitha njësitë përbërëse SHSKUK-së, me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe rritjes së besueshmërisë së qytetarëve për marrjen e shërbimeve shëndetësore
- Bashkëpunimi dhe përkrahja nga donatorët për furnizim me barna dhe material shpenzues Falë bashkëpunimit dhe përkrahjes, Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar ka pranuar donacion 675 shtretër nga Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA). Shtretërit janë shpërndarë në klinikat e QKUK-së dhe spitale të përgjithshme që menaxhohen nga ShSKUK. Ky donacion ka ndikuar në rritjen e numrit dhe cilësisë së shërbimeve.
- Gjatë këtij vitit në klinikën e Neurologjisë është aktivizuar shërbimi i kartelës elektronike për regjistrimi e pacientëve me Sklerozë Multiple. Aktivizimi është realizuar nga ana e Shërbimit të Teknologjisë Informative në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës fal Sistemi CLARIUM që ishte donacion nga kompania Roche që nga viti 2019, por nuk ishte funksionalizuar asnjëherë. Pacientët e diagnostikuar me Sklerozë Multiple, që marrin shërbime



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

mjekësore në Klinikën e Neurologjisë, tashe tutje do të kenë kartelën e tyre elektronike të regjistrimit.

- Pjesë e të arriturave gjate ketij viti ishte edhe hapja e bllokut të ri operativ me 4 salla operative në Klinikën e Ortopedisë, dhe funizimi me pajisje mjekësore ku kemi krijuar kushte moderne e të bëjnë më të lehtë punën e stafit mjekësor dhe trajtimin e pacientëve. Investim i projektit mbindërtimi dhe zgjerimi i objektit ekzistues të bllokut operativ të Klinikës së Ortopedisë u realizua nga Qendra Klinike Universitare të Kosovës.



- Me qëllim të ngritjes së numrit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore Drejtoria e Përgjithshme e SHSKUK ka arritur të bashkëpunoj dhe shkëmbejë përvoja në mes klinikave dhe institucioneve të ndryshme si: Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Kardiokirurgjisë dhe Kardiologjisë Intervente (INCCI) të Luksemburgut për ngritje të kapaciteteve të personelit shëndetësor të shërbimit të kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë intervente në Kosovë. Ka vazhduar bashkëpunimi dhe mbështetja me donacione me barna nga Federatës Botërore për Hemofili (ËFH) dhe të Fondacionit të Hemofilisë në Kosovë, ku i falënderoi për ndihmën e vazhdueshme dhënë QKUK-së, që kapin shuma milionëshe, për trajtimin e personave me hemofili. Pjesë e të arriturave është edhe bashkëpunimi dhe përkrahja nga profesori i njohur nga Australia, Pedy Deëan, ku së bashku me ekipin vendas të Klinikës së Kirurgjisë së Fëmijëve, në Qendrën Klinike Unversitare të Kosovës, janë operuar fëmijë me probleme të lindura kongjenitale. Edhe gjate ketij viti ka vazhduar misioni i përkrahur nga ShBA “Gift of Life International” dhe Holanda “Princess Maxima Hospital Holand” ku kardiokirurgët dhe kardiologë amerikanë kanë trajtuar fëmijët me probleme në zemër. Po ashtu mundësia e bashkëpunimit në mes të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës dhe Qendrës Klinike Spitalore në Zagreb të Kroacisë. Po ashtu mundësinë e bashkëpunimit ndërmjet Klinikës së Kirurgjisë Torakale dhe Klinikës së Kirurgjisë Torakale të Universitetit të Lubjanës në Slloveni.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

- Me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe uljes së listës së pritjes të pacientëve Kabineti i Endoskopisë në Klinikën e Gastroenterologjisë në QKUK është pajisur me 4 gastroskop dhe 4 kolonoskop të rinj dhe ridizajnim të hapësirave duke përmbushur plotësisht nevojat për trajtim endoskopik të pacientëve të kësaj klinike. Edhe Reparti i Hemato-Onkologjisë në Klinikën e Pediatriisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është bërë me pajisje të re për përgatitjen e kimioterapisë. Blerja e Kabinës së Sigurisë e mundëson që kjo terapi e ndjeshme të bëhet gati më lehtë dhe më shpejt dhe rrjedhimisht ofron më shumë siguri për personelin shëndetësor gjatë punës.
- Në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është hequr lista e pritjes për vendosjen e fistullës arterio-venoze, përmes së cilës mundësohet kryerja e procesit të Dializës. Fistulla arterio-venoze shërben në vend të kateterit të përkohshëm që përdoret në fillim të procesit të dializës, deri në zhvillim të fistullës.
- Rinovimi i kuzhinës në Qendrën Klinike Univerësitare të Kosovës, project i mbështetur nga Komanda e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Europë (European Command- EUCOM) përmes programit për Ndihmë Humanitare (Humanitarian Assistance) dhe Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje (Office of Defence Cooperation) në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë. Projekti kap vlerën 730 mijë dollare dhe përmes tij është bërë rinovimi i gjithë hapësirës së brendshme, duke përfshirë: dyert dhe dritaret, dyshemenë, muret, tavanet, rrejtin elektrik, rrjetin hidraulik-sanitar, ventilimin dhe pajisjet për kuzhinë.





Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

- Në Repartin e Radioterapisë të Klinikës së Onkologjisë është lëshuar në funksion Tomografinë e Kompjuterizuar për simulimin e pacientëve (CT Simulator), Kjo pajisje është dora e fundit e teknologjisë, i cili është blerë nga Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës dhe ka kushtuar 345 mijë e 900 euro.



- Hapja e objektit të Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive dhe Klinikës së Mjekësisë Fizikale me Rehabilitim Mjekësor. Këto dy institucione që funksionojnë në kuadër të ShSKUK-së, tashmë janë vendosur në objekt modern, me infrastrukturë dhe pajisje mjekësore të sofistikuara dhe do të ofrojnë shërbime shëndetësore shumë më cilësore për sportistët dhe pacientët që kanë nevojë për shërbime shëndetësore.



- Rinovimi i disa nga klinikat QKSUK-së, ka mundësuar ofrimin e shërbimeve moderne dhe mundësi për ngritjen e mëtejme të numrit shërbimeve.
- Rritja e mbështetjes së ndërsjellë si dhe bashkëpunimit të deritashëm në mes SHSKUK-së dhe FSK-së, respektivisht Regjimentit mjekësor të FSK-së dhe komponentëve tjera mjekësore.
- Ri nënshkrimi i Memorandum- bashkëpunimit ndërmjet Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës dhe Policisë së Kosovës për kryerjen e vizitave sistematike të Kadetëve të Policisë së Kosovës në QKUK.
- Aktivizimi me orare të rregullta të konziliumeve mjekësore – Bordet e tumoreve nëpër Klinikat e QKUK-së.
- Planifikimi dhe inicimi i kërkesës në MSH për futjen në planifikime të krijimit të Udhërrëfyesve dhe Protokoleve Klinike për të gjitha lëmitë që trajtojnë pacientë në kuadër të ShSKUK-së.
- Krijimi i grupeve punuese për hartimin e rregulloreve të brendshme klinikave, instituteve dhe shërbimeve të QKUK-së.
- Krijimi i grupit punues për hartimin e një plani konkret për nevojat dhe riorganizmin e stafit mjekësor të klinikave, instituteve dhe shërbimeve të QKUK-së
- Inicimi i procedurave në përmirësimin e furnizimit me barna dhe material shpenzues.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

- Inicimi i mekanizmave shtes në kontrollimin dhe monitorimin për furnizim me barëna dhe material shpenzues mjekësor.
- Hapat e nevojshëm në shpërndarjen me kohë të produkteve medicinale sipas kërkesave të njësisë.
- Ngritja e bashkëpunimit me donatorët për furnizim me barna dhe materiale shpenzuese mjekësor.
- Reduktimi i listave të pritjes së pacientëve në disa shërbime,
- Inicimi i procedurave ligjore për sigurimin e resurseve të nevojshme në SHSKUK-së.

Gjatë kësaj periudhe SHSKUK-së u përball edhe me sfida të ndryshme, si rifillimi i kohpaskohshme i shtimit të rasteve të pacientëve me pandemin Covid-19, vonesat në furnizim me barëna dhe material shpenzues dhe shpërndarje e tyre nëpër njesit e ShSKUK, etj.

- Mos nënshkrimi dhe procedimi me kohë për furnizim me barëna dhe material hargjues nga njesit e SHSKUK.
- Vonesat në inicime të proceduarve tenderuese për një pjesë të madhe të barnave dhe produkteve medicinale dhe higjienike të planifikuara, kanë sjellë situata jo të lakmueshme, duke bërë të detyrueshme nevojën e menaxhmentit të bëjë zgjedhje emergjente.
- Problemet me vonesat e procedimit të lëndëve në OSHP, për pasojë vonesat në furnizime të rregullta me barna dhe produkte e paisje medicinale.
- Problemet me vonesa në liferime me kohë të barnave dhe produkteve medicinale.
- Problem evident ngelet siguria fizike e Objekteve dhe Hapësiravë të QKUK-së, ku gjatë këtij viti janë evidentuar 4 incidente të rënda, për të cilat po merren insitucionet përkatëse.
- Moszabatimi në nivele të duhuara i rregullave shtëpiake nëpër disa Klinika dhe Shërbime klinike të QKUK-së, pjesë e cila ju takon Menaxhmenteve të Klinikave dhe Kompanise se Sigurimit fizik në kuadër të QKUK-së.
- Mungesa e rregullores së brendshme të punës dhe organogramit të ShSKUK-së.
- Mbingarkimi i Klinikave Emergjente, me trajtimin e pacientëve etj.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Shërbimet e realizuara në SHSKUK

Në SHSKUK-së, gjatë periudhës Janar-Djetor 2022 janë ofruar gjithësejt **7,737,599** shërbime të ndryshme. Nga këto shërbimet kemi **770,952** ditë shërimi në nivel të Republikës së Kosovës me gjithësejt **152,365** pacientë të shtrirë.

Nga shërbimet e realizuara janë:

- Operime 40,744
- Vizita ambulantore 1,429,546
- Vizita tjera diagnostike 618,237,
- Paramentra laboratorik 3,990,411 për 549,520 pacientë.
- Shërbime radiologjike 379,189
- Shërbime tjera apo të veçanta janë kryer 1,142,130
- Dializa janë kryer 118,095 dializa.
- Lindje, janë gjithësejt 19,247 Nga këto lindje me operim janë kryer 6,774, ndërsa fëmijë të lindur kemi 19,482

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacient në SHSKUK gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022 është 5.1 ditë ndërsa shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve të ShSKUK-së është 56%.

1. Struktura e të punësuarve në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës në strukturën organizative gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 kishte gjithsej 7,145 punëtorë në listën e pagave. Sipas kualifikimeve

profesionale, Mjekë specialistë janë 1,629 apo 23%, kurse stafit

infirmier/e janë 3,997 apo 56% dhe punëtorë jo shëndetësor administrativ dhe teknik nga lëmit e ndryshme janë gjithësej 1,519 apo 21% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në SHSKUK.





Figure 1. Struktura e të punësuarve sipas përgaditjes profesionale në SHSKUK



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)


2. Performanca e punës në SHSKUK Janar-Dhjetor 2022





Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

3. Numri i pacientëve dhe shfrytëzueshmëria e kapaciteteve sipas njësive në SHSKUK, Janar-Dhjetor 2023.



Sipas raporteve gjatë vitit 2022 në nivel të SHSKUK-së, kanë qenë të shtrirë 152,365 pacientë me 770,952 ditë shërimi. Në QSHM-SHIB-QIRSKP-Shtime ishin 64 pacientë të rregullt me 22,953 ditë shërimi. Në spitale të përgjithshme ishin 75,686 pacientë të shtrirë me 305,556 ditë shërimi dhe në QKUK ishin 77,615 pacientë të shtrirë me 442,443 ditë shërimi, pra QKUK kishte numër më të madhë të pacientëve dhe ditë shërimi.

Figure 1 Numri i pacientëve dhe ditë shërimi janar-dhjetor 2022 ne SHSKUK




Figure 2 Shfrytëzueshmëria dhe kohëzgjatja mesatarë e shërimit sipas njësive në SHSKUK Janar-dhjetor 2022

Në kuadër të SHSKUK-së, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022, në QKUK kemi 67% të shfrytëzueshmërisë së kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit për një pacientë është 5.7 ditë, në spitale të përgjithshme kemi 43% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit është 4.1 ditë dhe njësit tjera QSHM-SHIB- konkretisht QIRSKP-Shtime kemi 97% të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe mesatarja e ditëve të shërimit është 1 ditë për pacientë.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

4. Shërbimet e kryera në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës

Në kuadër të SHSKUK-së, janë ofruar gjithësejt 7,737,599 shërbime. Nga këto shërbime të kryera kemi: 770,952 ditë shërimi me gjithësejt 152,365 pacientë të shtrirë. Nga numri i pacientëve të shtrirë janë operuar 40,744 pacientë në njësit e SHSKUK, ndërsa janë realizuar 1,429,546 vizita ambulantore dhe 618,237 vizita tjera diagnostike. Pashtu në njësit e SHSKUK-së janë realizuar 3,990,411 shërbime laboratorike për 549,520 pacientë apo për çdo pacientë mesatarisht janë realizuar 7.3 parametra laboratorik. Numri i lindjeve gjatë kësaj periudhe ishte 19,247 lindje, ku nga këto lindje 6,774 janë lindje me operim apo 35%, kurse fëmijë të lindur janë 19,482. Po ashtu janë kryer gjithësejt 118,095 shërbime të dializës dhe shërbime tjera apo të veçanta mvarësisht nga specifikat e shërbimeve janë kryer 1,142,130 shërbimeve dhe shërbime radiologjike janë kryer 379,189 branda periudhës Janar-Dhjetor 2022.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë ishte 5.1 ditë, kurse shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në njësit e SHSKUK është 56%.

Qendrën Klinike Universitare e Kosovës, gjatë periudhës Janar-Djetor 2022 në 1,807 shtretër kanë qenë 442,443 ditë shërimi nga 77,615 pacientë të shtrirë. Nga pacientët e shtrirë janë operuara 23,410 pacientë, po ashtu janë ofruar 496,958 vizita ambulantore, 264,300 vizita tjera diagnostike dhe 450,954 shërbime tjera apo të veçanta, 19,052 Anesteziione. Gjatë këtij viti janë kryer 1,756,500 shërbime laboratorike për 350,532. Janë realizuar 37,113 dializa. Nga numri i shërbimeve diagnostike kemi 159,775 shërbime radiologjike që janë kryer, dhe janë realizuar 8,804 lindje, ku nga ky numër i lindje 3235 janë realizuar me operim dhe janë lindur 8,967 fëmijë. *Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve është 67% ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit në QKUK është 5.7 për ditë.*

Spitalet e Përgjithshme, me 1,933 shtretër për periudhën Janar-Dhjetor 2022, kishin 305,556 ditë shërimi për 74,686 pacientë të shtrirë. Nga pacientët e shtrirë janë operuar 17,334 pacientë dhe janë realizuar 806,094 vizita ambulantore, vizita tjera diagnostike 266,485 dhe shërbime tjera apo të veçanta 269,816. Po ashtu në këto njësi janë kryer 2,133,288 parametra laboratorik për 191,763 pacientë. Shërbime radiologjike janë kryer gjithësejt 213,072 shërbime, janë realizuar 80,982 dializa dhe janë kryer 10,443 lindje, ku nga këto lindje 3,539 janë kryer me operim dhe janë lindur 10,515 fëmijë. *Shfrytëzimi i kapaciteteve në spitale të përgjithshme është 43% kurse mesatarja e ditëve të shërimit është 4.1 për ditë.*

Qendren Klinike Stomatologjike Universitare e Kosovës- QKSUK, janë trajtuar 10,899 pacientë nëpër klinika po ashtu janë kryer gjithsej 59,499 vizita të para dhe vizita kontrolluese. Aktivitete –Shërbime si dhe ato jashtë Prishtinës 293,205 shërbime të kryera.

Qendra Kombëtare e Telemjekësisë së Kosovës-QKTK, ka ofruar trajnime profesionale dhe telekonferenca, publikime shkencore, etj. Për 9,752 staf mjekësor (mjekë specialistë, infermierë, specializant dhe të tjerë). Nga këta Mjekë Specialist 4,892 dhe Studentë 4,860.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës-QKMP në Gjakovë gjatë muajit Janar-Dhjetor 2022 janë kryer gjithësejt 194,709 shërbime. Nga shërbimet e kryera janë 28,859 vizita ambulantore, 56,317 vizita tjera diagnostike, shërbime laboratorike janë kryer 100,623 parametra për 7,225 pacientë dhe 2,568 shërbime tjera. Gjithashtu në këtë njësi janë kryer 6,342 shërbime radiologjike.

Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive- QKMS, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 janë kryer gjithësejt 14,596 shërbime, nga këto shërbime janë 414 vizita specialistike dhe 308 terapi fizikale si shërbime tjera apo të veçanta dhe 13,874 vizita tjera diagnostike.

Qendrat e Shëndeti Mendor me Shtëpitë për Intergrim në Bashkësi, me 8 njësi në të gjithë Kosovën, gjithësejt periudhe kishte 64 pacientë të shtrirë me 22,953 ditë shërimi vetëm në QIRSKP-Shtime. Ndërsa në përgjithësi në QSHM-SHIB, janë kryer 27,970 vizita psikiatrike-psikologu- si vizita ambulantore, po ashtu janë kryer 6,362 vizita tjera diagnostike si vizita shtëpiake, dhe 106,227 shërbime të veçanta nga këto janë 58,704 terapi okupuese, art, sport, argetim, 42,059 qëndrim ditor dhe 5,464 shërbime të punëtorit social si shërbime tjera apo të veçanta.

5. Struktura e të punësuarve në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës QKUK

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në listën e të punësuarve janë gjithësejt 3,324 punonjës. Sipas strukturës profesionale nga ky numër i të punësuarve kemi: Mjekë Specialist 819 apo 25% nga numri i përgjithshëm i stafit. Infermierë 1,864 apo të shprehur në përqindje 56% dhe Staf jo shëndetësor janë 641 punonjës apo 19% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve në QKUK-së.




Figure 3 struktura e të punësuarve në SHSKUK




Figure 4 % e të punësuarve në SHSKUK sipas profesioneve



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

6. Performanca e punës në Qendren Klinike Universitar të Kosovës Janar-Dhjetor 2022




Figure 5 shërbimet e kryera në QKUK



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 në 1,807 shtretër kanë qenë 77,615 pacientë të shtrirë dhe 442,443 ditë shërimi. Nga pacientët e shtrirë janë operuar 23,410 pacientë, po ashtu janë ofruar 496,958 vizita ambulantore dhe 264,300 vizita tjera diagnostike, 159,775 shërbime radiologjike, 19,052 anestezone. Po ashtu janë kryer 1,756,500 shërbime laboratorike për 350,532 pacientë dhe janë kryer 450,954 shërbime tjera apo të veçanta.

Në Klinikën e Radiologjisë dhe Mjekësin Nuklerare janë kryer gjithësejt 159,775 shërbime të ndryshme diagnostike- radiologjike si: (MRI, CT, Ultrazë, Radiografi, Angjiografi, Mamografi, Sintigrafi të pjesë të nryshme trupore, Densitometri të kockave dhe shërbime tjera radiologjike).

Në klinikën e Nefrologjisë janë kryer gjithësejt 36,999 shërbime të dializës, dhe Klinikën e Pediatriisë janë kryer 114 dializa ne total jane kryer 37,113 dializa.

Në KOGJ janë kryer 8804 lindje në total, nga këto lindje 3,235 janë lindje me operim, ndërsa fëmijë kanë lindur 8,967.

Në Klinikën e Kardiologjisë dhe Kardiokirurgjisë janë kryer 2,929 koronografi, nga këto konarografi kemi 1,730 stent procedura, ndërsa janë vendosur 2,727 stenta.

Në klinikën e Kardiokirurgjisë janë kryer 350 operacione kardiokirurgjike.

Në klinikën e Anestezionit dhe Reanimacionit janë 15,129 ditë shërimi me 6,439 pacientë të shtrirë, ndërsa janë kryer 76,473 vizita ambulantore dhe janë kryer 19,052 anestezone nëper klinika të ndrysheme.

Në Klinikën e Onkologjisë janë 2.348 ditë shërimi me 348 pacientë të shtrirë dhe 47,351 vizita ambulantore dhe 9,763 vizita tjer adiagnostike, po ashtu janë kryer 15,774 shërbime të veçanta, janë dhënë 32,351 terapi me citostatik. Sipas patologjive raste të reja janë paraqitur 1,736 pacientë.

Mesatarja e ditëve të shërimit për pacientë gjatë kësaj periudhe ishte 5.7 ditë, kurse shfrytëzimi mesatara i kapaciteteve në QKUK është 67%

6.1. Shërbimet shëndetësore të ofruara në QKUK -Janar-Dhjetor 2022

Nr	Njësit	Nr i Shtr etër ve	Ditë shërim i	Nr. të shtrir ëve	Nr.të operu arve	Vizita ambula ntore	Vizita tjera diagno stike	Shërbi me radiol ogjike	Shërbim e laborato rike	Dializ a	Anestez ione	Lindje	Shërbime tjera/apo te vecanta	Shfr i kapacit eteve	Sheri mi
1	Klinika Obstetrike Gjinekologjike	318	68,745	15,997	5,961	1,614	55,812					8,804	136,454	59%	4.3
2	Klinika e Dermatovenerologjisë	30	7,582	859	-	15,913	3,016						8,164	69%	8.8
3	Klinika e Kirurgjisë Abdominale	69	14,408	2,757	1,712	4,302	5,955						3,714	57%	5.2
4	Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale	24	5784	729	1,051	3,720							1,399	66%	7.9
5	Klinika Ortopedisë dhe Traumatologjisë	104	16,899	2,232	1,964	27,327	2,044						16,687	45%	7.6
6	Klinika e Kirurgjisë Torakale	24	6,889	813	503	3,556	1,322						1,902	79%	8.5
7	Klinika e Gastroenterologjisë	33	9,261	1,082	-	6,653	8,996						10,523	77%	8.6
8	Klinika e Hematologjisë	20	5,238	639		4,398	5,282						6,935	72%	8.2
9	Klinika e Neonotalogjisë	170	33,511	9,563		2,329	1,235						2,488	54%	3.5
10	Klinika Infektive	120	22,810	2,604		10,252	7,019						3,107	52%	8.8
11	Klinika e Syve	58	16,024	3,555	3,687	41,986	2,078						6,391	76%	4.5
12	Klinika e Nefrologjisë	18	5,323	631		3,633	6,807			36,999			9,514	81%	8.4
13	Shërbimi i Ortoprotetikës					1,343							1,384		
14	Klinika e Pulmologjisë	66	23,147	1,846		16,122	10,651						4,794	96%	12.5
15	Klinika e Kardiologjisë	75	26,935	6,376		14,064	27,020						37,880	98%	4.2
16	Klinika e Pediatrisë	151	50,770	7,124		20,127	20,861			114			37,692	92%	7.1
17	Klinika e Endokrinologjisë	36	8,045	720		12,507	7,276						24,500	61%	11.2
18	Klinika e Anesteziologjisë dhe Reanimacionit	64	15,129	6,439		76,473					19,052			65%	2.3
19	Klinika e ORL-së	64	22,826	2,192	2,124	8,836	10,894						9,502	98%	10.4
20	Klinika e Neurologjisë	58	16,191	1,904		13,122	13,128						14,026	76%	8.5
21	Klinika e Biokimisë Mjekësore								1,756,500						
22	Shërbimi Mjekësisë Nukleare					742		8,239					8,100		
23	Shërbimi Klinik Emergjent	19				92,615							5,666	0%	
24	Klinika e Mjekësisë Fizikale dhe Rehabilitim	15	2,914	165	-	9,017	2,983						51,170	53%	17.7
25	Klinika e Kirurgjisë Plastike	21	3,631	681	1,924	8,406	593						11,572	47%	5.3



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

26	Klinika e Neurokirurgjisë	24	5,274	816	643	4,079	2,473						3,817	60%	6.5
27	Klinika e Urologjisë	24	6,209	1,404	983	6,700	2,219						1,920	71%	4.4
28	Klinika e Onkologjisë	12	2,348	348	-	47,351	9,763						15,774	54%	6.7
29	Klinika e Kardiokirurgjisë	14	5,621	663	350	1,916	4,601						5,597	110%	8.5
30	Klinika e Psikiatrisë	58	12,103	603		12,966	2,583						3,458	57%	20.1
31	Klinika e Radiologjisë							151,536							
32	Klinika e Reumatologjisë	27	7,878	1,647	-	8,609	3,235						923	80%	4.8
33	Klinika e Kirurgjisë së Fëmijëve	20	5,118	1,483	1,306	4,392	1,794						58	70%	3.5
34	Klinika Kirurgji Vaskulare	24	6,326	1,405	1,202	8,164	2,514						1,203	72%	4.5
35	Klinika e Alergologjisë me Imunologji	11	1,488	307		3,213	1,944						55	37%	4.8
36	Instituti i Psikiatrisë Forenzike	36	8,016	31		511	244						1,895	61%	259
37	Instituti Paraklinike						19,504						2,690		
38	Shërbimi i Mikrobiologjisë Klinike						20,454								
	Total	1,807	442,443	77,615	23,410	496,958	264,300	159,775	1,756,500	37,113	19,052	8,804	450,954	67%	5.7

Gjatë kësaj periudhe kohore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës sipas të dhënave nga raportet vazhdon të prijë me numër më të madhe të pacientëve Klinika e Gjinekologjisë me gjithsej 15,997 pacient të shtrirë dhe me 68,745 ditë shërimi, dhe 5,961 pacient të operuar, përveç shumë shërbimeve të realizuara në këtë klinikë gjatë kësaj periudhe janë realizuara 8,804 lindje, nga këto lindje 3,235 lindja të realizuara me operacion nga të gjitha këto lindje kemi 8,967 fëmijë të lindur në Klinikën e KOGJ, dhe të njejtë janë transferuar në Klinikën e Neonatologjisë për trajtim të më tej sipas protokoleve. Klinika e Neonatologjisë në QKUK, gjithsej kishte 9,563 pacient të shtrirë me gjithsej 33,511 ditë shërimi, shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve 54%.



Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (SHSKUK)

Klinika e Anestezionit dhe Reanimacionit ka kryer 19,052 anestezone, numri i pacientëve të shtrirë 6,439 dhe 15,129 ditë shërimi.

